



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 5 lidhur me nenin 7, pika 3, të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012”, nenit 4, lidhur me nenin 5, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

1.1 JEPET PËLQIMI- për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1, (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës parcela si më poshtë:

1.2 Stadiumi i qytetit (futbollit) i ndërtuar në parcelën kadastrale P-72116046-02285-0 sipas certifikatës Nr.101-2018 të datës 02.05.2018, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtura “**Gradina**”, me sipërfaqe të përgjithshme prej **10372m²** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012” dhe të Rregullores (QRK) Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”, nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S – S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI